



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 105, Datë 16/04/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 33, datë 28.02.2018, e Znj. G.GJ., ku pretendohet diskriminim për shkak të “racës” (egjiptiane), nga ana e Infinit Construction sh.a¹.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesja ka punuar prej disa vitesh pranë Infinit Construction sh.a., firmë pastrimi në qytetin e Beratit. G.GJ. pretendon se kjo firmë nuk e ka paguar rregullisht për punën e kryer dhe në momentin që ajo është ankuar për këtë çështje, është larguar padrejtësisht nga puna. Ankuesja pretendon se është diskriminuar nga Infinit Construction sh.a, pasi ajo i përket komunitetit egjiptian.

Në vijim të depozitimit të ankesës së sipërpërmendur, Z. B.D., i cili duke iu referuar shënimeve në formularin e ankesës, është cilësuar si përfaqësues i komunitetit egjiptian dhe person kontakti

¹ Infinit Construction sh.a është firmë pastrimi në qytetin e Beratit.